



KATALOG – CATALOG

USHTARËT SHQIPTARË TË VRARË NË ARMATËN E ISH-JUGOSLLAVISË (RSFJ)

ALBANIAN SOLDIERS KILLED IN THE FORMER YUGOSLAV ARMY (SFRY)



Prishtinë / Pristina
2025

Zá n'Kujtesë
A Voice in Memory

Katalog - Catalog
Ushtarët shqiptarë të vrarë në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ)
Albanian Soldiers Killed in the Army of the Former Yugoslavia
(SFRY)

Botues / Publisher

Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë
Institute of Crimes Committed during the War in Kosovo
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"
The National Library of Kosovo "Pjetër Bogdani"

Kryeredaktor i botimeve / Editor-in-Chief of publications
Atdhe Hetemi
Blerina Rogova Gaxha

Këshilli redaktues / The editorial board
Shqipe Canolli
Aranit Krasniqi
Rrezarta Ahmeti
Shkëndije Berisha
Bedrije Mekolli

Këshilli hulumtues / Research board
Albiana Arbeni
Sofije Grajçevci
Sedat Sahitaj
Greta Avdyli
Kimete Haxholli
Mimoza Gjevori
Ilir Berisha
Bleona Maxharraj

Dizejnatorë / Designers
Drilon Selmani
Gentrit Ibishi

Në ballinë: Kufoma e ushtarit Fatmir Krasniqi – autori Ridvan Slivova
On the front page: The body of the soldier Fatmir Krasniqi – author Ridvan Slivova

Katalog - Catalog

Ushtarët shqiptarë të vrarë në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) Albanian Soldiers Killed in the Army of the Former Yugoslavia (SFRY)

Ky katalog botohet nga Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", me rastin e realizimit të ekspozitës *"Ushtarët shqiptarë të vrarë në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ)"*, realizimit të forumit me të njëjtën tematikë dhe debutimit të kolanës së botimeve *"Zë n'Kujtesë"* të Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë.

"This catalog is published by the Institute of Crimes Committed During the War in Kosovo in cooperation with the National Library of Kosovo "Pjetër Bogdani", on the occasion of the exhibition 'Albanian Soldiers Killed in the Army of the Former Yugoslavia (SFRY)', the organization of a forum on the same topic, and the debut of the publication series *"A Voice in Memory"* by the Institute of Crimes Committed During the War in Kosovo."

**Prishtinë / Pristina
2025**

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

017:355.11(=18:496.51:497.1)(092)

Katalog : ushtarët shqiptarë të vrarë në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) = Catalog : Albanian Soldiers Killed in the Army of the Former Yugoslavia (SFRY) / kryeredaktor i botimeve Atdhe Hetemi, Blerina Rogova Gaxha. - Prishtinë : Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë ; Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, 2025. - 40 f. : ilustr. ; 25 cm.

Titulli dhe teksti paralel në gjuhën shqipe dhe angleze

1. Hetemi, Atdhe 2. Gaxha, Blerina Rogova

ISBN 978-9951-9232-0-0

Kjo ekspozitë organizohet si pjesë e serisë së forumeve Zá n'Kujtesë të Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL), kësaj here e realizuar në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, synon të vë në pah një nga faqet më të errëta të historisë tragjike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi: fatin e dhimbshëm të qindra të rinjve shqiptarë, të cilët humbën jetën në rrethana të dyshimta gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak në Armatën Popullore të Jugosllavisë (APJ).

Këto krime mbeten në errësirë, për shkak të zhvillimeve të mëvonshme historike, të cilat në vitet dhe dekadat që pasuan, me shpejtësi i eklipsuan ato në kujtesën dhe traumën kolektive. Ky fenomen përbën një nga krimet më të pazbuluara në gjithë historinë e armatës së ish-Jugosllavisë, ku të rinj që ishin thirrur të shërbenin për një shtet formalisht federativ dhe ‘vëllazëror’, eliminoheshin pikërisht nga institucioni që duhej t'i mbronte.

Fenomeni i vrasjeve të ushtarëve shqiptarë në ushtrinë popullore jugosllave përcolli popullin shqiptar, pjesë e ish-Jugosllavisë, prej fundit të Luftës së Dytë Botërore, duke kulmuar në dekadën e viteve të 80-ta, vetëm gjatë të cilës u vranë rreth 135 ushtarë shqiptarë, që kryenin shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Shkundja e sistemit të brendshëm jugosllav me vdekjen e Josip Broz Titos, si dhe me demonstratat masive që shpërthyen në Kosovë, në vitin 1981, shkaktuan pasiguri në nomenklaturën jugosllave, e cila filloi aplikimin e masave për shtypjen e popullsisë shqiptare, të cilën e paraqitnin si ‘më dashakeqen’ ndaj sistemit jugosllav.

Mes masave të shumta represive si arrestimet, burgosjet, torturimet, përjashtimet nga puna, propaganda mediatike shtroi rrugën për eskalimin e represionit dhe dhunës, përgjatë dekadës dhe kalimit në dhunë e aparteid të hapur në dekadën 1990-1999. Popullsia shqiptare iu bë presion edhe përmes vrasjeve të rekrutëve të rinj, që kryenin shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Të vrarë, jo në luftë, por në kazerma në kohë të paqes, këta djem shqiptarë - shumica në moshë fare të re - u bënë viktimat e një politike sistematike të shtypjes dhe diskriminimit, që buronte nga strukturat më të larta politike e ushtarake jugosllave. Nuk bëhej fjalë për incidente të izoluara, por për një model të përsëritur dhune disa dekadash, që si duket kishte për qëllim nënshtrimin psikologjik dhe frikësimin kolektiv të shqiptarëve, një popullsie në rritje, e cila perceptohej si kërcënim nga nacionalizmi serb, që atë kohë dominonte strukturat e shtetit jugosllav.

Ky kapitull i errët i historisë, ende sot mbetet i pa hulumtuar, dhe pa drejtësi. Në mungesë të hetimeve të pavarura ndërkombëtare dhe pa një përballje të sinqertë me të kaluarën nga shteti pasardhës i ish-Jugosllavisë – Serbisë - plagët e asaj periudhe mbeten ende të hapura. Megjithatë dokumentimi i këtyre krimeve, ruajtja e kujtesës dhe përkujtimi i viktimave nuk është vetëm një akt drejtësie për familjet e tyre, por edhe një detyrë historike dhe morale për të mos lejuar që harresa të bëhet bashkëfajtores e krimit.

Këto krime, ashtu si edhe shumë forma të tjera të dhunës sistematike dhe diskriminimit institucional ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi, nuk mbetën pa pasoja. Në njërën anë, ato kontribuan drejtpërdrejt në ndërtimin e një klime të ngulfatjes dhe tensionit të akumuluar ndër vite, e cila shpërtheu me forcë në rezistencën e armatosur të viteve 1998–1999. Mungesa e drejtësisë, mohimi i të vërtetës dhe vazhdimi i praktikave shtypëse në çdo segment të jetës, përfshirë edhe ushtrinë, e bënë të pashmangshme përplasjen mes një populli që kërkonte liri dhe një regjimi që ushtronte dhunë për të ruajtur kontrollin.

Lufta në Kosovë nuk ishte një shpërthim i papritur, por rezultat i shtresimit të

krimeve të dhimbshme, i dekadave të represionit të institucionalizuar, përfshirë edhe vrasjet misterioze të të rinjve shqiptarë në kazemat e një ushtrie, që për ta, nuk përfaqësonte më as mbrojtje, as atdhe. Në anën tjetër, këto krime shtruan rrugën e represionit dhe dehumanizimit ndaj popullit shqiptar, që eskaloj deri në pikën më kulminante në aparteid shtetëror gjatë viteve '90 dhe ndërmarrje shtetërore-ushtarake për krime kundër njerëzimit në vitet '98-'99, që detyruan edhe ndërhyrjen e Aleancës Perëndimore për ndalimin e një ndërmarrje të tillë.

Megjithatë, kërkimi për drejtësi nuk ka përfunduar. Jo vetëm familjet e viktimave, por edhe institucionet shtetërore të Kosovës kanë të drejtën dhe detyrimin të kërkojnë drejtësi dhe reparacione për këto krime të rënda. Viktimat janë vrarë brenda kazermave ushtarake, në ambiente të mbyllura dhe nën kontroll të plotë të shtetit jugosllav të asaj kohe, ku për secilën kazermë dihet saktësisht kush ka qenë në krye të komandës ushtarake dhe i gjithë zinxhiri i përgjegjësisë. Në këtë drejtim, këto krime nuk janë vetëm morale apo politike, por përbëjnë edhe shkelje të rëndë të së drejtës penale ndërkombëtare, veçanërisht të Konventave të Gjenevës, si dhe mund të kategorizohen si krime kundër njerëzimit, për shkak të karakterit të tyre sistematik dhe të drejtuar ndaj një grupi të caktuar etnik.

IKKL ka mandat ligjor, që të hulumtojë dhe dokumentojë, jo vetëm krimet e kryera gjatë periudhës së luftës së viteve 1998-1999, por edhe politikat dhe veprimet përgjatë viteve dhe dekadave të mëhershme që çuan deri te kjo luftë.

Andaj, Instituti synon që përtej dokumentimit të krimeve të kryera gjatë viteve 1998-1999, të dokumentojë edhe fenomenin e vrasjes së rekrutëve shqiptarë, në ushtrinë popullore jugosllave; të zbulohet numri i saktë dhe shtrirja e këtij krimi nëpër kazerma në gjithë territorin e shtetit të ish-Jugosllavisë.

Hapja e kësaj ekspozite dhe mbajtja e forumit me të njëjtën tematikë, përtej kujtimit të të rënëve dhe dhembjes, që ende prek familjet e tyre, synon të jetë hapi i parë drejt një projekti të gjatë të IKKL-së për dokumentimin edhe të këtij krimi.

Katalogu i dokumentimit të këtyre rasteve dhe forumi aktual, ka për qëllim, jo vetëm përkujtimin dhe dokumentimin historik, por edhe ndërgjegjësimin publik dhe ndërkombëtar, për domosdoshmërinë e ndjekjes penale të këtyre krimeve. Synimi është që përmes mekanizmave të drejtësisë ndërkombëtare, të fillojë një proces i vërtetë ballafaqimi me të kaluarën dhe vendosja e drejtësisë për viktimat dhe familjet e tyre. Heshtja nuk duhet të jetë trashëgimia e vetme, që u mbetet atyre që humbën më të dashurit e tyre në kohë paqeje, brenda një institucioni që duhej të ishte më i sigurti.

Ky katalog ofron një pasqyrë të përmbledhur për krimet që ushtria jugosllave ka kryer ndaj të rinjve shqiptarë gjatë periudhës së shërbimit ushtarak në APJ. Katalogu ka si qëllim të sjellë para opinionit vendor dhe ndërkombëtar ekzistencën e dëshmimeve, fakteve dhe provave të mbledhura.

Katalogu dhe ekspozita përmbajnë materiale të siguruar nga arkivi i IKKL-së si dhe nga familjarë, studiues e gazetarë, fotoreporterë të kohës, të cilët kanë lejuar përdorimin e këtyre materialeve për këtë ekspozitë.

Ekspozita është konceptuar si paraqitje e ciklit jetësor të ushtarëve, e cila përfshin dy faza: e para nis me fotografi-portrete duke shpërfaqur identitetin e tyre, momente nga shërbimi ushtarak, copëza letrash dore - si gjësende personale të tyre, dokumente që dëshmojnë vrasjet e inskenuara dhe rekrutimin e dhunshëm të të rinjve shqiptarë. Faza e dytë vazhdon me 'kthimin' e tyre në atdhe, vajtimin e nënave shqiptare në ceremonitë mortore të bijve të tyre, nderimin nga popullata shqiptare, dokumentimin nga mediet dhe përkujtimin nga familjarët – si zë i kujtesës së përmotshme.

Kjo ekspozitë është edhe një thirrje për reflektim dhe për të siguruar që krimet e kryera, të cilat kanë shënuar një periudhë të errët të historisë sonë, të mos harrohen dhe të trajtohen me seriozitetin që meriton çdo akt dhune dhe padrejtësie.

Në fund, dua të shpreh falënderimin dhe mirënjohjen time të thellë për fotografën Ridvan Slivova, i cili ka dhuruar fotografi të ceremonisë së varrimit të ushtarit Fatmir Krasniqi, nanën e të ndjerit Abedin Krasniqi - Mihane Krasniqi, për fisnikërinë e saj, familjen Morina, familjen Muja, familjen Bala, Cen Deskun dhe gjithë familjarët e tjerë, që kanë dhuruar fotografi dhe materiale dokumentare për bijtë e tyre, duke na mundësuar realizimin e kësaj ekspozite.

Atdhe Hetemi

This exhibition is organized as part of the A Voice in Memory (Zá n'Kujtesë) forum series by the Institute of Crimes Committed During the War in Kosovo (ICCW) and on this occasion, it is realized in cooperation with the National Library of Kosovo "Pjetër Bogdani." The exhibition aims to shed light on one of the darkest chapters in the tragic history of Albanians in the former Yugoslavia: the painful fate of hundreds of young Albanians who lost their lives under suspicious circumstances while performing mandatory military service in the Yugoslav People's Army (YPA).

These crimes remained shrouded in darkness due to subsequent historical events, which in the years and decades that followed, quickly eclipsed them in the collective memory and trauma. This phenomenon represents one of the most under-investigated crimes in the entire history of the former Yugoslav army - where young men, recruited to serve a state that was formally federal and 'brotherly,' were in fact eliminated by the very institution that was meant to protect them.

The phenomenon of the killing of Albanian soldiers in the Yugoslav People's Army followed the Albanian population of former Yugoslavia from the end of World War II, reaching its peak during the 1980s - a decade during which approximately 135 Albanian soldiers were killed while performing their mandatory military service. The internal destabilization of the Yugoslav system, triggered by the death of Josip Broz Tito and the outbreak of mass demonstrations in Kosovo in 1981, generated anxiety within the Yugoslav political elite. In response, the regime began implementing repressive measures aimed at suppressing the Albanian population, whom it portrayed as the most disloyal element within the federation.

Among the wide range of repressive actions - arrests, imprisonments, torture, dismissals from employment and orchestrated media propaganda - the killings of young Albanian recruits became a tool of systemic pressure. These young men, killed not in combat but within military barracks during peacetime, became victims of a deliberate policy of suppression and discrimination rooted in the highest echelons of the Yugoslav political and military establishment. These were not isolated incidents, but part of a recurring, decades-long pattern of violence that appears to have been designed to achieve the psychological suppression and collective intimidation of the Albanian people - a growing population increasingly perceived as a threat by the Serbian nationalism that had come to dominate the structures of the Yugoslav state.

This dark chapter of history remains, to this day, unresearched and without justice. In the absence of independent international inquiries and a genuine reckoning with the past by Serbia, the successor state of former Yugoslavia, the wounds of that period remain open. Documenting these crimes, preserving memory, and commemorating the victims is not only an act of justice for their families, but also a historical and moral obligation - to ensure that oblivion does not become an accomplice to the crime.

This crime, like many other forms of systematic violence and institutional discrimination against Albanians in the former Yugoslavia, did not come without consequences. On one hand, it directly contributed to the creation of a climate of suffocation and long-standing tension, which ultimately erupted in the armed resistance of 1998-1999. The absence of justice, denial of truth and the continuation of repressive practices across every aspect of life - including within the military - made the confrontation between a people demanding freedom and a regime wielding violence to maintain control inevitable.

The war in Kosovo was not a sudden outburst, but the result of layers of painful crimes and decades of institutionalized repression, including the mysterious killings of young Albanians in the barracks of an army that, for them, no longer represented protection or their homeland. On the other hand, this crime paved the way for broader repression and dehumanization of the Albanian population - culminating in a state-led apartheid during the 1990s and a state-military campaign of crimes against humanity in 1998–1999, which ultimately compelled Western intervention to halt such an enterprise

Nevertheless, the search of justice is far from over. Not only do the families of the victims, but also the state institutions of Kosovo have both the right and the obligation to seek justice and reparations for these grave crimes. The victims were killed inside military barracks - closed environments under the full control of the Yugoslav state at the time - where the chain of command and those responsible for each facility are clearly known. In this context, these crimes are not solely moral or political in nature; they also constitute serious violations of international criminal law, particularly the Geneva Conventions. Given their systematic nature and their targeting of a specific ethnic group, they can be classified as crimes against humanity.

ICCW holds a legal mandate not only to research and document crimes committed during the war 1998–1999, but also to examine the policies and actions throughout the preceding years and decades that led to the outbreak of that war.

Therefore, beyond documenting the crimes committed during the 1998–1999 period, the Institute aims to investigate and document the phenomenon of the killing of Albanian recruits in the Yugoslav People's Army. The goal is to uncover the exact number of victims and the extent of this crime across military barracks throughout the territory of the former Yugoslav state.

The opening of this exhibition and the hosting of the forum on the same theme - beyond honoring the memory of the fallen and acknowledging the ongoing pain endured by their families - aim to serve as the first step in a long-term project by ICCW to document this specific crime as well.

The documentation catalog of these cases, along with the current forum, aims not only to preserve historical memory and commemoration, but also to raise public and international awareness about the urgent need for criminal prosecution of these crimes. The objective is to initiate a genuine process of reckoning with the past and to establish justice for the victims and their families through international legal mechanisms. Silence must not be the only legacy left to those who lost their loved ones in peacetime, within an institution that was supposed to be among the safest.

This catalog provides a summarized overview of the crimes committed by the Yugoslav army against young Albanians during their military service in the Yugoslav People's Army (YPA). The catalog aims to present to both the national and international public the existence of testimonies, facts and evidence that have been collected.

The catalog and exhibition contain materials sourced from the ICCW archives as well as from family members, researchers, journalists and photojournalists of the time, who have permitted the use of these materials for this exhibition.

The exhibition is designed to present the life cycle of the soldiers, which is divided into two phases. The first phase begins with portrait photographs showcasing their identities, moments from their military service, fragments of personal letters - objects that belonged to them - documents that testify to the

staged murders and the forced recruitment of young Albanians. The second phase continues with their 'return' to their homeland, the mourning of Albanian mothers at the funeral ceremonies of their sons, the honors paid by the Albanian population, the media documentation, and the remembrance by family members - serving as a voice for eternal memory.

This exhibition is also a call for reflection and for ensuring that the crimes committed, which marked a dark period in our history, are not forgotten and are treated with the seriousness that every act of violence and injustice deserves.

In the end, I would like to express my deep gratitude and appreciation to photographer Ridvan Slivova, who has provided us with photographs from the funeral ceremony of soldier Fatmir Krasniqi, the mother of deceased Abedin Krasniqi - Mihane Krasniqi, for her nobility. I also extend my thanks to the Morina family, the Muja family, the Bala family, Cen Desku and all other family members who have generously shared photographs and documentary materials of their sons, as well as for enabling the realization of this exhibition

Atdhe Hetemi

Fytyra nën hije, emra pa zë

Shadowed Faces, Names without a Voice



Agim (Salih) Gllareva

U rekrutua në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1990.

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Mihrije Gllareva, motra e të ndjerit.

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1990.

Photography and data: from the family collection, provided by Mihrije Gllareva, sister of the deceased.

Fytyra nën hije, emra pa zë

Shadowed Faces, Names without a Voice



Ali (Sinan) Rrustemi

U rekrutua në armatën ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1992.

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Bislim Bislimi, familjar i të ndjerit.

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1992.

Photography and data: from the family collection, provided by Bislim Bislimi, cousin of the deceased.

Fytyra nën hije, emra pa zë

Shadowed Faces, Names without a Voice



Nazmi (Avdulla) Muja

U rekrutua në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1982.

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Hafiz Muja, vëllai i të ndjerit.

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1982.

Photography and data: from the family collection, provided by Hafiz Muja, brother of the deceased.

Fytyra nën hije, emra pa zë

Shadowed Faces, Names without a Voice



Sami (Ali) Gashi

U rekrutua në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1980.

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Florije Gashi, motra e të ndjerit.

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1980.

Photography and data: from the family collection, provided by Florije Gashi, sister of the deceased.

Fytyra nën hije, emra pa zë

Shadowed Faces, Names without a Voice



Abedin Balaj

U rekrutua në armatën ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1985.

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Fadil Bala, vëllai i të ndjerit.

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1985.

Photography and data: from the family collection, provided by Fadil Bala, brother of the deceased.

Fytyra nën hije, emra pa zë

Shadowed Faces, Names without a Voice



Abedin Krasniqi

U rekrutua në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1991.
Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi KKAFFZHK.

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1991.
Photography and data: from ICCW Archives, KKAFFZHK Fonds.

Fytyra nën hije, emra pa zë

Shadowed Faces, Names without a Voice



Haki Morina

U rekrutua në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1991.

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Familja Morina.

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1991.

Photography and data: from the family collection, provided by Morina Family.

Fytyra nën hije, emra pa zë

Shadowed Faces, Names without a Voice



Jetullah Desku

U rekrutua në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1990.
Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Cen Desku.

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1990.
Photography and data: from the family collection, provided by ICCW Archives, Cen Desku Fonds.

Shërbimi i detyrueshëm, jeta e pezullt

Mandatory service, a suspended life.



Haki Morina

Gjatë shërbimit ushtarak: (në mes, radha sipër).

U rekrutua në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1991.

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Familja Morina.

During military service: (center, top row).

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1991.

Photography and data: from the family collection, provided by the Morina family.

Shërbimi i detyrueshëm, jeta e pezullt

Mandatory service, a suspended life.



Nazmi Muja

Gjatë shërbimit ushtarak, Nazmi Muja (në anën e djathtë), i vrarë gjatë shërbimit ushtarak.

Fotografia dhe të dhënat: ofruar nga Mihrije Muja, motra e të ndjerit.

During military service, Nazmi Muja (on the right), killed during his service.

Photography and data: provided by Mihrije Muja, sister of the deceased.

Shërbimi i detyrueshëm, jeta e pezullt

Mandatory service, a suspended life.




Osman Ismajli

U rekrutua në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1988.
Osman Ismajli (në mes), i vrarë gjatë shërbimit ushtarak.
Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi KKAFFZH.

Recruited into the Yugoslav People's Army (SFRY) in 1988.
Osman Ismajli (center), killed during military service.
Photography and data: from the ICCW Archive, KKAFFZH Fonds.

Fjalët që u kthyen pa zë

Words that returned without a voice



Letra e ushtarit Nazmi Muja

Shkruar nga Nazmi Muja, gjatë shërbimit ushtarak: më 5 prill, 1982, në ora 21:30, në shkrim dore – pjesa e parë.

Letra dhe të dhënat: ofruar nga Mihrije Muja, motra e të ndjerit.

Letter from soldier Nazmi Muja

Written by Nazmi Muja during his military service: April 5, 1982, at 21:30, handwritten – part one.

Letter and data: provided by Mihrije Muja, sister of the deceased.

Vula mbi gënjeshtër

The seal on the lie

Forma e certifikatës së vdekjes së ushtarit të Forcës së Armatës së ish-Jugosllavisë (RSFJ)

USHAKRIMEDICINARIA ALBANIJA

1. Emri i ushtarit: **KRASNII ABEDIN** **muški**

2. Data e lindjes: **03.11.1991.**

3. Vendi i lindjes: **Beograd**

4. Emri i bashkëshortit: **Saveta Vences**

5. Data e vdekjes: **7.11.1991.**

6. Vendi i vdekjes: **Pristina**

7. Emri i bashkëshortit: **Mali Beleshevac**

8. Emri i bashkëshortit: **Mali Beleshevac**

9. Emri i bashkëshortit: **Pristina**

10. Emri i bashkëshortit: **SFRJ**

11. Emri i bashkëshortit: **Krasniqi Sabid**

12. Emri i bashkëshortit: **dr. Z. Stanovick**

13. Emri i bashkëshortit: **dr. Z. Stanovick**

14. Data e vdekjes: **03.11.1991.**

Certifikata e 'vdekjes' së ushtarit Abedin Krasniqi

Lëshuar më 3 nëntor, 1991.

Dëshmia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi KKAFFZH.


'Death' Certificate of Soldier Abedin Krasniqi

Issued on November 3, 1991.

Testimony and data: from the ICCW Archive, KKAFFZH Fonds.

Ftesa që nuk mund të refuzohej

The Invitation that could not be refused



Dëshmi dokumentare

Raport që dëshmon përpjekjen serbe për t'i rekrutuar shqiptarët në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në periudhë të vonë, viti 1997.

Dëshmia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Musë Berisha.

Documentary Evidence

A report demonstrating Serbian efforts to recruit Albanians into the Yugoslav People's Army (SFRY) in the later period, year 1997.

Evidence and data: from the ICCW Archive, Musë Berisha Fonds.

The Invitation that could not be refused



Raport që dëshmon përpjekjen serbe për t'i rekrutuar shqiptarët në mënyrë të dhunshme në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në periudhë të vonë, viti 1997.
Dëshmia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Musë Berisha.

A report demonstrating Serbian efforts to recruit Albanians into the Yugoslav People's Army (SFYR) in the later period, year 1997.

Evidence and data: from the ICCW Archive, Musë Berisha Fonds.



Kufoma e ushtarit Fatmir Krasniqi

I vrarë në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ), (Prishtinë, më 24 maj, 1991).
Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Ridvan Slivova.

The body of the soldier Fatmir Krasniqi

Killed in the Yugoslav People's Army (SFRY), (Pristina, May 24, 1991).
Photography and data: from the ICCW Archive, Ridvan Slivova Fonds.



Nëna pranë arkivolit të birit të saj, Fatmir Krasniqi

I vrarë në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ), (Pristinë, më 24 maj, 1991).
Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Ridvan Slivova.

The mother beside the coffin of her son, Fatmir Krasniqi

Killed in the Yugoslav People's Army (SFRY), (Pristina, May 24, 1991).
Photography and data: from the ICCW Archive, Ridvan Slivova Fonds.



Nderimi i ushtarit të vrarë, Fatmir Krasniqi

Kortezhi i varrimit, (Prishtinë, më 24 maj, 1991).

Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Ridvan Slivova.

Honoring the Fallen Soldier, Fatmir Krasniqi

Funeral procession, (Pristina, May 24, 1991).

Photography and data: from the ICCW Archive, Ridvan Slivova Fonds.



Ceremonia e varrimit të ushtarit të vrarë, Fatmir Krasniqi

(në kornizë, fotografia e tij), (Prishtinë, 24 maj, 1991) .

Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Ridvan Slivova.

The funeral ceremony of the Fallen Soldier, Fatmir Krasniqi

(in the frame, his photograph), (Pristina, May 24, 1991).

Photography and data: from the ICCW Archive, Ridvan Slivova Fonds.

Një jetë u shua, por një komb u ngrit në këmbë

A life was extinguished, but a nation rose to its feet



Pjesëmarrja e mijëra qytetarëve të Kosovës në ceremoninë e varrimit të ushtarit të vrarë, Fatmir Krasniqi

(Prishtinë, 24 maj, 1991).

Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Ridvan Slivova.

The participation of thousands of citizens of Kosovo in the funeral ceremony of the Fallen Soldier, Fatmir Krasniqi

(Pristina, May 24, 1991).

Photography and data: from the ICCW Archive, Ridvan Slivova Fonds.



Ceremonia e varrimit të ushtarit të vrarë, Haki Morina (në kornizë, fotografia e tij)
I vrarë gjatë shërbimit në armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ), (Gllarevë, Klinë, 26 tetor, 1991).

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Familja Morina.

The Funeral Ceremony of the Fallen Soldier, Haki Morina (in the frame, his photograph)

Killed during service in the Yugoslav People's Army (SFRY), (Gllarevë, Klinë, October 26, 1991).

Photography and data: from the family collection, provided by the Morina family.



Nderim për ushtarin e vrarë, Haki Morina

Gjatë ceremonisë së varrimit, (Gllarevë, Klinë, 26 tetor, 1991).

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Familja Morina.

Honor for the Fallen Soldier, Haki Morina

During the funeral ceremony, (Gllarevë, Klinë, October 26, 1991).

Photography and data: from the family collection, provided by the Morina family.



Momentet e fundit nga ceremonia e varrimit të ushtarit të vrarë, Haki Morina (Gllarevë, Klinë, 26 tetor, 1991).

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Familja Morina.

The Final Moments from the Funeral Ceremony of the Fallen Soldier, Haki Morina (Gllarevë, Klinë, October 26, 1991).

Photography and data: from the family collection, provided by the Morina family.



Artikuj për vrasjen e ushtari Fatmir Krasniqi në gazetën Bujku
Faqe nga gazeta Bujku me artikuj të botuar për rastin e vrasjes së ushtari Fatmir Krasniqi:

Vdiq tragjikisht ushtari Fatmir Krasniqi, autor: R. B. Demiri, 23 maj, 1999

Djalin tim e vranë!, autor: H. I., 23 maj, 1991

Vdekja e ushtarit, provokim i rëndë, autor: B. K., 23 maj, 1991

Pikëllim i thellë i bashkëfshatarëve, autor: B. K., 23 maj, 1991

Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Ridvan Slivova.

Articles on the murder of Soldier Fatmir Krasniqi in Bujku Newspaper
Pages from Bujku newspaper featuring articles published about the murder of soldier Fatmir Krasniqi:

The Tragic Death of Soldier Fatmir Krasniqi, author: R. B. Demiri, May 23, 1999

My son was murdered! author: H. I., May 23, 1991

The Death of the Soldier, a Grave Provocation, author: B. K., May 23, 1991

Deep Sorrow of fellow Villagers, author: B. K., May 23, 1991

Photography and data: from the Archive of ICCW, Ridvan Slivova Fonds.



Artikull për varrosjen e ushtarit Fatmir Krasniqi në gazetën Bujku

Dje, në varrezat e Prishtinës u varros me nderime Fatmir Krasniqi, autorë: Z. Gecaj dhe R. B. Demiri, botuar më 25 maj, 1991, në gazetën Bujku. Fotografia dhe të dhënat: nga Arkivi i IKKL-së, Fondi Ridvan Slivova.

Article about the burial of Soldier Fatmir Krasniqi in the Bujku Newspaper

Yesterday, in the Pristina cemetery, Fatmir Krasniqi was buried with honors. Authors: Z. Gecaj and R. B. Demiri, published on May 25, 1991, in the Bujku newspaper.

Photography and data: from the ICCW Archive, Ridvan Slivova Fonds.



Përkujtesë në shtypin e kohës – një javë pas vdekjes së ushtarit, Abedin (Selman) Balaj, më 19 janar, 1985

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Fadil Bala, vëllai i të ndjerit.

Tribute in the press of the time – one week after the death of Soldier Abedin (Selman) Balaj, on January 19, 1985

Photography and details: from the family collection, provided by Fadil Bala, brother of the deceased.



Ceremoni përkujtimore në nderim të ushtarit, Haki Morina (1970-1991)

Fotografia dhe të dhënat: nga koleksioni familjar, ofruar nga Familja Morina.

Memorial Ceremony in Honor of the Soldier, Haki Morina (1970-1991)

Photography and details: from the family collection, provided by the Morina Family.

ISBN 978-9951-9232-0-0



9 789951 923200